




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRIN	
Nr. / Br.	51334/21
Nr. i fq. / Br. st.	- 1 -
Data: / Datum:	21/09/21
VUSHTRRI - VUČITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë mbajtur në fshatin Pantinë, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 28.08.2021 me fillim në ora 17:00, në Shkollën "Gj.K. Skenderbeu".
Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës etj.

Nga banorët e atij lokaliteti ishin të pranishëm 8 pjesëmarrës. Prej tyre 6 meshkuj dhe 2 femra.

Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtër lidhur me investimet e bëra gjatë këtyre viteve të udhëheqjes së tij me komunën, duke filluar me projektet infrastrukturore si shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Bedri Imeri, si problem e cekë rrethojën e shkollës, ku kërkon që të bëhet rrethoja e shkollës për shkak të sigurisë së nxënësve.

2. Shyqyri Kamberi, kërkon të rregullohet problemi me kanalizim te rruga afër lumit të fshatit.
3. Driton Kamberi, kërkon që rruga “Musa Ismajli” të rregullohet.
4. Gani Binaku, kërkon të ketë ndriçim te përmendorja e dëshmorit “Jeton Tërstena”.

Në fund u theksua se këto kërkesa do të shqyrtohen në ekzekutivin e komunës, komitetin për politikë dhe financa dhe rekomandohen për miratim në kuvendin e komunës për aprovim varësisht prej prioriteteve që do të përcaktohen si dhe varësisht prej disponueshmërisë buxhetore për investime kapitale për v. 2022-2024.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

